



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

Këshilli
Konsultativ



Procesverbali i Mbledhjes

Këshilli Konsultativ mes Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore

Mbledhja e datës 8 nëntor 2024

Tabela e Përmbajtjes

Hapja e mbledhjes.....	1
1. Analizë e Buxhetit Vendor	1
2. Projektvendimi “Mbi procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit të strehimit social.....	2
3. Projektvendimi “Për bazën e të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar dhe vendor”.....	3
4. Projektligji “Për shitjen e pasurive të paluajtshme shtetërore poseduesëve faktikë jopronare në zonat me përparësi zhvillimin e ekonomisë malor	4
5. Projektvendimi “Buxheti i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2025.....	5
6. Projektligjin “Për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit”.....	7
7. Projektudhëzimi “Për radhën e vendosjes së elementëve të adresës, algoritmin dhe strukturën e kodit unik të adresës dhe përdorimin e tij	6
8. Projektvendimi “Për disa ndryshime në Vendimin nr.1139, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026 dhe të planit të veprimit 2021-2023”.....	8
9. Projekti “Forcimi i Kapaciteteve Institucionale Vendore për Migracionin në Shqipëri”.....	9
Mbyllja e mbledhjes	11

Shtojcë: Të pranishëm

Hapja e mbledhjes

Në zbatim të VKM nr. 244, datë 17.4.2024 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjes Vendore”, u mbajt mbledhja e tetë për vitin 2024 pranë Salla Amantia 1-2-3, Hotel Marriott, Tiranë, datë 4 nëntor 2024. Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Këshillit Konsultativ, përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe donatorë të huaj. Mbledhja u kryesua nga bashkëkryetarët e Këshillit Konsultativ, *Z. Arbjan Mazniku, Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor* dhe *Z. Aldrin Dalipi Kryetar i Këshillit të Qarkut Tiranë*, i cili në fjalën e tij përshëndetëse falenderoi shoqatat dhe përfaqësuesit e NJVV-ve.

Z. Arbjan Mazniku Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor bëri ”**Analizën makro të Buxhetit Vendor**” për vitin 2025 duke theksuar rëndësinë e buxhetit për këtë vit si një alokim i qenësishëm për pushtetin vendor. Te ardhurat e veta totale janë llogaritur prej 11.7% me një përmirësim me

totalin e të ardhura për vitin që shkoi, ku theksohen bashkitë turstike me fluks turistësh. Transferta e pakushtëzuar totale ka një rritje prej 17.1% me shumë se vitin e kaluar. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme ka një rritje prej 7.7% në 26.2 miliardë lekë. Transferta e pakushtëzuar sektoriale ka një rritje prej 23.2% në 13.3 miliardë lekë. Buxheti për arsimin parashkollor ka rritje prej 25.7%, arsimi parauniversitar ka një rritje prej 4.1%, mbrojtja nga zjarri ka një rritje prej 36.4%, mbrojtja sociale ka një rritje prej 7.2%, administrimi i pyjeve ka rritje prej 4.7%, rrugët rurale kanë rritje me 3,1%, ujitja dhe kullimi kanë rritje me 3.9%, pagat kanë rritje me 133% krahasuar me vitin që shkoi, menaxhimi i mbetjeve është me 14.7% me shumë se vitin që kaloi. Pavarsisht të dhënave të censusit asnjë bashki nuk ka me pak se vitin e kaluar duke e trajtuar buxhetin vendor si prioritet nga qeveria.

Znj. Adelina Farrici, Drejtoreshë Ekzekutive. Shoqata për Autonominë Vendore shprehu optimizmin për buxhetin e akorduar bashkive duke iu përmbajtur 1% e GDP-së, por duhet të ishte me shumë se 1%.

Z. Mazniku shprehu dakordësinë duke theksuar se rritja e buxhetit për bashkitë po shkon në rritje vit pas viti.

PROJEKTAKTE TË KONSULTUARA

- 1. “Mbi procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit të strehimit social”**
- 2. “Për bazën e të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar dhe vendor”**

Znj. Dardana Grabovaj, Drejtor, Drejtoria e Strehimit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ose MEKI prezantoi dy aktet “Mbi procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit të strehimit social” si dhe projektvendimin “Për bazën e të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar dhe vendor”. Të dy vendimet e strehimit lidhen me njëra tjetrën ku shpjegon hapat që ndiqen për apilkimin për strehimin social, ku këto ishin parashtruar dhe në vendimin e mëparshëm i cili kishte paqartësi për rolet në sistem. Tashmë janë inkorporuar rolet e secilit. Për projektvendimin e dytë kemi pasur pyetje se sa të pastrehë ka Shqipëria të cilën nuk e kemi disponuar si rezultat i mospasjes së të dhënave në nivel kombëtar. Projektvendimi bën të mundur të gjenerohen të dhënat në të gjitha bashkitë e vendit dhe ky sistem mirembahet dhe administrohet nga MEKI dhe 61 bashkitë e vendit. Baza e të dhënave jep në kohë reale sa të strehuar janë sa të pastrehuar janë, sa banesa sociale ka dhe sa troje ka të disponueshme në mënyrë që të ndërtohen banesa sociale. Projektvendimi ka 14 nene ku parashikon strukturat përgjegjëse për zbatimin e vendimit si dhe të dhënat që do mbajë ky sistem dhe është i aksesueshëm për çdo qytetar.

Z. Agron Haxhimali, Instituti për Demokracinë Vendore theksoi rëndësinë e aktit për strehimin mbi bazën e të dhënave si një dokument i rëndësishëm për Shqipërinë dhe qasjen e tij.

Z. Aldin Dalipi theksoi se mund të jenë të shpërndarë në secilën bashki një databazë por një e dhënë në nivel kombëtar e zgjidh këtë problem.

Znj. Juliana Memaj, Kryetare, bashkia Dimal theksoi se është i rëndësishëm akti dhe duhet një afat për përbledhjen e mendimeve nga ana jonë.

Z. Aldin Dalipi theksoi se AMVV do kordinojë afatet për mbledhjen e mendimeve për aktet nga bashkitë.

Z. Mikel Qafa nënkryetar, bashkia Fushë-arrëz theksoi se në lidhje me buxhetin kush e menaxhon meqenëse do i kalojë kjo përgjegjësi bashkisë dhe për bashkite që nuk kanë banesa sociale si do veprohet. Si dhe citohet se updetimi bëhet një herë në tre muaj dhe kjo nëse është në kohë reale të bëhet si në e-albania.

Znj. Grabovaj theksoi se angazhimet nga ana financiare i merr ministria përgjegjëse MEKI dhe për bashkitë që nuk kanë banesa sociale krijohen dhe ndërtohen me buxhetin e ministrisë ose nga Enti Kombëtar i Banesave. Afati tre muaj është lënë në mënyrë që të përditësohen dhe mund ta bëjë bashkia në çdo kohë.

Znj. Memaj theksoi se në vendim për tarifën me personat me aftësi të kufizuar do paguhet nga NJVV ku shtohen detyrimet dhe fondet janë të cinguara.

Znj. Grabovaj theksoi se ligji ka parashikuar lehtësira qoftë për ata me kontratë qeraje e cila bëhet pranë bashkisë e cila është hequr si barrë për qyetarët, dhe kur pronari e kërkon me noter kjo do financohet nga qeveria, me pak i është lënë bashkisë në buxhetin e vet.

Znj. Denisa Meçi, Sekretare e Përgjithshme, Bashkia Pukë, shtroi pyetjen në lidhje me pikën 8 në kushte emergjente për strehim ku bashkia Pukë ka disa nevoja ku kemi fonde të limituara si dhe elemnti kohë për strehimin përderisa po zgjat si shumë problematika e strehimit.

Znj. Grabovaj argumentoi në lidhje me pikën 8 është parashikuar në ligj që jepet bonusi i qerasë për aq kohë sa të zgjidhet një çështje tjetër për strehim, ndërsa për raste emergjente bashkia merr masa ose i adreson te ministria përgjegjëse për strehim. Kemi shpallur një vendim për qëllime strehimi në rsatet e prishjes së banesave dhe kompensimit të tyre dhe pajisen me një banesë tjetër.

Z. Rudin Bega, nënkryetar, bashkia Shkodër argumentoi në lidhje me rastet emergjente ku kemi një problem me strehimin informal, ku 70% e tyre nuk janë banorë të bashkisë Shkodër.

Znj. Grabovaj theksoi se për këto banorë duhet të rregullohen ligjërisht që të bëhen pjesë e bashkisë tuaj në mënyrë që ju të ndërveproni dhe të bëni kërkesa në ministri dhe për ata banorë që janë në banesë të përkoshme që janë nga Fushë-Kruja, duhet të komunikoni me bashkinë Fushë-Krujë për sistemimin e tyre sipas instrumentave ligjor.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ.

3. Projektligji “Për shitjen e pasurive të paluajtshme shtetërore poseduesëve faktikë jopronare në zonat me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore”

Z Enkelejd Muabelliu zv/minister Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, MEKI..... prezantoi projektaktin “Për shitjen e pasurive të paluajtshme shtetërore poseduesëve faktikë jopronare në zonat me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore” duke zgjidhur problematikën e titujve të pronësisë për faktin se ligji 7501 nuk është aplikuar në zonat malore dhe posedimi i pronave malore është një fakt dhe është kthyer në një problematikë të zhvillimit të këtyre zonave.

Efektet Ligji i shtrinë vetëm në zonat me përparësi ekonominë malore. Një rol të rëndësishëm do ketë dhe AZHT dhe posedues fakti është personi fizik apo juridik që e ka poseduar pronën në gjendje të pandërprere për një periudhë prej 10 vitesh. Identifikimi i këtyre personave parashikohet të bëhet nga NJVV-të cilat do bashkëveprojne me institucione të tjera shtetërore si dhe komisionet ad hoc për identifikimin e këtyre personave. Pasuritë që të cilësohen të transferueshe duhet të plotësojnë disa kriteret. Komisioni ad hoc bën inventarizimin dhe identifikimin e pasurive në këto zona me përparësi zhvillim të ekonomisë malore. Iniciativën mund ta marrin dhe individët duke ju drejtuar NJVV-ve, ndërsa pasuritë e identifikuar do inventarizohen nga ASHK-ja. Për pasuritë e NJVV-ve do i kalonje ministrisë me vendim të Këshillit Bashkiak ose me Vkm kur janë të një ministrie, pastaj ministria do lidhë kontratën prej 1 euro për të ja kaluar poseduesve faktik jopronar dhe vetëm atyre që kanë një projekt të mirëfillt për zhvillimin e kësaj pasurie.

Z. Gledjan Llatja, kryetar, bashkia Elbasan theksoi rëndësinë e ligjit dhe duhet të shtohen në ligj dhe për zonat kodrinore si ullahtet apo vreshta që kanë një potencial për zhvillimin e turizmit, *Znj. Majlinda Bufi, bashkia Roskoves*, shprehu dakordësinë me kryetarin e bashkisë Elbasan në lidhje me propozimin e tij duke ditur që shumë bashki kanë zona kodrinore.

Në lidhje me **projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”**, *Z. Mazniku* u shpreh për Vkm 867 për legalizimet ku i është dhënë e drejta për firmosjen e dokumentave bashkive me ASHK-në. Akti është bazik dhe i jep bashkisë të drejtën të firmosin dokumentat në territor dhe linjëzon në një gjuhë të dy mekanizmat për të qënë teknikisht në rregull.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t’i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ.

4. Projektligji “Buxheti i Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2025”

Z. Fran Brahim, Drejtor për Financat Vendore, Ministria e Financave prezantoi projektligjin “*Buxheti i Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2025*”. Jemi duke punuar me një projekt për financat lokale për një reformin të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit të bashkive për të rritur shërbimet dhe punët publike në nivel vendor dhe konsiston duke e kthyer programin buxhetor në një program drejtues në bashkitë pilot dhe do zgjatet për dy vite të ardhshme dhe në bashkitë e tjera. Jemi duke punuar me Ministrinë e Shtetit për Pushtetin Vendor për digjitalizimin e shërbimeve të pushtetit vendor dhe për financat si ato të taksave. Për vitin 2025 buxheti vendor zë 3.43% të buxhetit të brendshëm bruto, që është një pjesë e buxhetit, por është 17-20% pjesë e buxhetit që i shtohet kësaj shume. Shpenzimet e buxhetit vendor janë 89.9 miliardë, ka një rritje prej 10.5 miliardë euro nga viti 2024, të ardhurat parashikohen të jenë 3.6 miliardë më të mëdha se në vitin 2024. Dhe në krahasim me vitin 2025 janë 20 miliardë me shumë. Buxheti vendor rritet me 13.2% në krahasim me vitin 2024. Transferta e pakushtëzuar është 26.2 miliardë lekë në vitin 2025, në krahasim me vitin 2024 është rritur në vlerën 1.8 miliardë lekë, dhe krahasuar me vitin 2015 është rritur me 13.9 miliardë lekë. Transferta e pakushtëzuar për çdo bashki në vitin 2025, do të jetë me rritje mesatare në nivelin rreth 8.2% dhe për qarqet me një rritje mesatare në nivelin

rreth 3% krahasuar me një vit më parë dhe për qarqet ka një rritje, por më të vogël. Vazhdimi i financimit të funksioneve të transferuara në pushtetin vendor në vitin 2016, në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale në vlerën 13.1 miliard lekë. Rritja e pagave në buxhetin vendor 2025 për të mbuluar efektin financiar shtesë për rritjen e kufirit minimal të nivelit të pagave për NJVQV-të, me një fond shtesë prej 3.5 miliard lekë. Financimi i grantit të performancës në shumën 200 milion lekë me qëllim nxitjen e bashkive për të përmirësuar performancën e tyre në qeverisje. taksa e pasurisë është parashikuar në vlerën 8.6 miliard lekë dhe krahasuar me vitin 2024, rreth 2 miliard lekë më shumë të ardhura për njësitë e vetëqeverisjes vendore; për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (një zjarrfikës për 1500 – 2000 banorë) për 15 bashki, me një fond shtesë prej 221.1 milion lekë. Financimi i shpenzimeve operative për funksionet e transferuara, me një fond shtesë prej 444.8 milion lekë, ose rreth 4 % më shumë se një vit më parë. Të ardhurat e bashkive nga taksat e ndara, krahasuar me vitin 2015, para reformës administrativo-territoriale, do të rriten me rreth 1.5 miliard lekë për vitin 2025, duke përfshirë shpërndarjen e tatimit mbi të ardhurat personale dhe taksën e rentës minerare Financimi shtesë i funksioneve të arsimit parashkollor, administrimit të pyjeve dhe mbrojtjes sociale, në shumën 20 milion lekë për disa bashki nga buxheti i shtetit. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme ka shtesë 1,864 miliardë lekë. Transferta e pakushtëzuar sektoriale ka shtesë 2,238 miliardë lekë. Censusi i vitit 2023 rezultoi me ulje të numrit të popullsisë krahasuar me censusin e vitit 2011 me 397,852 banorë ose 14.21% më pak. Me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar, në formulën e vitit 2025 është vendosur një rregull fiskal që asnjë njësi e vetëqeverisjes vendore nuk do të marrë më pak se 105% të fondeve që i janë akorduar në vitin 2024. Buxheti vendor 2025, rreth 13.2% më i lartë se i vitit 2024. Shpenzimet vendore për vitin 2025, janë 89.861 miliardë lekë ose 3.43 përqind e PBB-së. Të ardhurat nga taksat vendore për 2025, parashikohen 40.7 miliard lekë, me një rritje rreth 10% krahasuar me vitin 2024. Transferta e pakushtëzuar, nga 24.3 miliardë lekë në 2024, në 26.2 miliardë lekë në 2025. Transferta e pakushtëzuar për çdo bashki me rritje mesatare në nivelin 8.2% dhe për qarqet me një rritje mesatare në nivelin rreth 3% krahasuar me vitin 2024. Rritja e pagave në buxhetin e vitit 2025 me mbështetje financiare nga qeveria qendrore, në vlerën 3.5 miliardë lekë dhe për funksionet e transfertat e pakushtëzuar për banorë është rritur nga 7.297 lekë në 2024, në 8.543 lekë në 2025. Të ardhurat vendore për banorë janë rritur nga 11.143 lekë në 2024, në 13.292 lekë në 2025. Shpenzimet vendore për banorë janë rritur nga 23.832 lekë në 2024, në 29.293 lekë në 2025. Transferta për mbrojtjen civile, në masën 800 milion lekë, e cila shpërndahet me formulë në formën e transfertës së kushtëzuar. Fondi 200 milion lekë, në zërin shpenzime kapitale në programin “Emergjencat Civile” të Ministrisë së Mbrojtjes përdoret për eliminimin e pasojave në rastet e fatkeqësive natyrore dhe shpërndahet gjatë vitit buxhetor. Fondi prej 1 000 milion lekë në zërin shpenzime kapitale në programin “Emergjencat Civile” të Ministrisë së Mbrojtjes akordohet me vendim të Këshillit të Ministrave për financimin e projekteve që lidhen me parandalimin e fatkeqësive natyrore, sipas kriterëve në aneksin 6 të ligjit të buxhetit. Fondi prej 200 milionë lekë në zërin shpenzime kapitale në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes akordohet me vendim të Këshillit të Ministrave për financimin e projekteve që lidhen me digat, sipas kriterëve në aneksin 7 bashkëlidhur këtij ligji. Transferta për menaxhimin e mbetjeve urbane (819.6 milion lekë për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore), përdoret/shpërndahet në përputhje me kriteret e vendosura në aneksin 7 të ligjit të buxhetit.

Investime për rikonstruksion/ndërtim ujësjellësash për bashkitë janë parashikuar në vlerën 2.9 miliard lekë. Fondi i parashikuar për rikonstruksion qendra kulturore, adaptimi i godinave për strehim social, ndërtimi dhe mobilimi i teatrit për bashkinë Tiranë në buxhetin 2025, në vlerën 1 miliard lekë. Investime për rikonstruksion, ndërtim dhe rehabilitim shkollash 9-vjecare/mesme

parashikohen në buxhetin 2025, në vlerën 2 miliard lekë. Investime për ndërtimin e tregjeve bujqësore në vlerën 600 milionë lekë. Investime nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për infrastrukturën vendore dhe rajonale në vlerën 6.2 miliard lekë. Fondi social në vlerën 330 milionë lekë. Qendrat rinore në bashki në vlerën 48 milionë lekë. Per vitin 2025 ku buxheti me autonomi të plotë financiare, do të jetë 3.43 % e PBB-së. Stoku i detyrimeve të prapambetura nga 12.1 miliard lekë në fillim të vitit 2016, në fund të vitit 2023 reduktuar në 4.8 miliard lekë ose ulur mbi 60 %. Transferta e pakushtëzuar për bashkitë është 97% ndërsa për qarqet është 3% Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë është 19,052,248,574 lekë, ndërsa për frymë është 6,211 lekë. Për të marrë në konsideratë diferencat në kostot e ofrimit të shërbimeve, NJVQV-të diferencohen mbi bazën e dendësisë së popullsisë.

Koeficienti, “dendësi e ulët e popullsisë”, çon fonde shtesë në njësinë. Në formulë 15% e totalit të fondit për bashkitë, alokohet mbi bazën e dendësisë së popullsisë, Përfituese janë NJVQV-të që kanë një dendësi populsië nën 110% të mesatares kombëtare prej 108 banorë për km². Transferta e pakushtëzuar sipas numrit të nxënësve është 1,190,765,536 leke pra I bie 3,413 lek/nxënës, ku 43 bashki fitojnë dhe 13 bashki humbasin. Bazuar në sistemin e ekualizimit, për të sjellë të gjitha bashkitë me të ardhura më “të ulta” në nivelin prej 90% të mesatares kombëtare, njësitë me të ardhura më të larta se 120% e mesatares kombëtare, do t’u merret 64% e diferencës midis të ardhurave të tyre për frymë dhe 120% të mesatares kombëtare, 48 bashkë pëfitojnë dhe 13 bashki dalin me minus në raport me vitin e mëparshëm por jo më pak t se 125%. Sfida për 2025 është ulja e detyrimeve të prapambetura, implementimi i AFMIS në nivel vendor, rritja e të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme/ndërtesës.

Z. Mariglen Disha, Kryetar, bashkia Librazhd, shtroi pyetjen nëse mund të aplikojmë për fonde për diasporën.

Z. Mazniku theksoi se nuk është e nevojshme, por bashkitë në funksionin e vet e kanë në lirinë e tyre për ndarjen e buxhetit për menaxhimin e diasporës si pjesë e analizën buxhetore të tyre, pra nuk vjen dot si zë i posaçëm.

Z. Agron Malaj, Kryetar, Bashkia Mat theksoi se bashkia Mat vetëm humbet si pasojë e lëvizjes së popullsisë si dhe shumica e anketave nuk janë kryer nëpër familje apo territore. Formula nuk korrespondon të jetë e saktë sepse në kemi detyrime dhe borxhe të kaluara si dhe investime të shtyra ndër vite. Ne kishim 8500 votues dhe dalim me 18 mij mijë banorë gjë që nuk gjen rakordimne formula në lidhje me paketën malore dhe bashkia Mat është më shumë kodrinor sesa malor.

Z. Mazniku shprehu dakordësinë me shqetësimin për censusin me kryetarin e bashkisë Mat, e cila është e dhënë zyrtare dhe jemi të detyruar ta përdorim në nivel kombëtar. Ato bashki edhe pse kanë rënie të popullsisë nuk marrin asnjë qindarkë me pak dhe në formulë nuk kemi kriter të përlllogaritjes së saj elementin lartësi por dendësia e popullsisë që është element diskriminues pozitiv që kanë një bonus më të madh, ndërsa për paketën malore duhet të mirëpresim definimet tuaja e të përfshije zonat kodrinore në këtë paket gjithashtu.

Z. Agron Malaj theksoi se shumë fshatra i kanë kaluar bashkive perreth të cilat kanë qenë nën adminstrimin e bashkisë Mat dhe për këtë arsye kemi pasur penalizime në censusin dhe Ministria

e Financave duhet të shikojë meqenëse jemi në proces gjyqësor dhe kemi planifikimet tona vjetore.

Z. Ergest Dule, kryetar, bashkia Konispol u shpreh në lidhje me diferencat e popullsisë në bashkinë Konispol të cilët janë zhvendosur në Finiq dhe Dropull. Transfetra sektoriale, rrugët rurale, menaxhimi i mbetjeve, ku për të njëjtën distancë mirëmbajte të rrugëve bashkisë i akordohet fondi në një shumë shumë më të vogël se nga ajo që mirëmban ARRSH. Në lidhje me mbetjet bashkitë që janë në distancë më të vogël me ladfillin përfitojnë transfertë për distancën dhe bashkia jonë nuk përfiton.

Z. Mazniku theksoi që mirëmbajta e rrugëve rurale është funksion i deleguar dhe sipas ligjit 139/2015 i mirëmban bashkia me buxhetin e vet dhe duhet të hiqet si zë më vete dhe të futet te granti. Programi i mbetjeve ka ardhur si rezultat i mbështetjes për bashkitë që kanë fluks për një kohë të shkurtër dhe rrit koston për banorët e asaj bashkie.

Z. Fran Brahimi dakordësoi me *Z. Mazniku* dhe theksoi se më vonë dhe transfertat sektoriale do përfshihet në një formulë të përgjithshme dhe ato janë venë për dukshmëri nga qeveria dhe në lidhje me mbetjet është Ministria e Mjedisit kompetente.

Znj. Memaj theksoi se për çfarë ishte kjo rritje apo vetëm për pagat dhe shprehu dakordësinë me kryetarin e bashkisë Konispol në lidhje me mirëmbajtjen e rrugëve për të cilat s'ka rritje dhe s'ka ndryshim, pra duhet të ketë rritje për këtë zë buxhetor dhe ajo që vjen është vetëm për pagat dhe duhet të saktësohet rritja në buxhet për shërbimet që u japim komunitetit.

Z. Brahimi theksoi se rritja e pagave është e qenësishme dhe bashkia Dimal ka rritje prej 14% në buxhetin e saj për transfertën e pakushtëzuar dhe për pjesën operative nga 2026 është rritur me 4%.

Z. Mazniku theksoi se transfertat sektoriale për funksionet e deleguara duhet të futet te formula e grantit.

Z. Llatja Kryetar, bashkia Elbasan theksoi se mbrojtja sociale mbulohet nga bashkia me taksat e veta me 52% të buxhetit, administrimin e pyjeve me 88% të buxhetit, rrugët rurale e mbështesim me 66% të vlerës, ujitjen dhe kullimin e mbështesim me 71% të vlerës. Bashkia Elbasan ka hequr nga të ardhurat e veta taksa dhe tatime rreth 2.8 milion euro për këto funksione të deleguara. Në lidhje me kriterin aneksi 2 pika 1 për transfertën e pakushtëzuar referuar kompensimit për përlllogaritjen gabim të formulës kërkojmë kompensimin prej 284 milion lekë qënga viti i transferimit të funksioneve.

Granti i pakushtëzuar apo i kushtëzuar i cili vjen për investime të drejtpërdrejta dhe ndryshimi i manualit të çmimeve nuk është pasqyruar te këto vlera. Për taksat dhe tarifatat e shoqërive tregtare të cilat janë shtetërore të përcaktohen në buxhetin e ministrisë përkatëse të cilat duhet të përcaktojnë taksat apo tarifatat tona vendore për këto ndërmarje apo shoqëri shtetërore. Kemi nevojë për mbështetje financiare për mirëmbajtjen e impiantit të përpunimit të mbetjeve e cila i kalon bashkisë Elbasan dhe për shtatë bashkitë e tjera siç është skema për qarkun Durrës.

Z. Ervis Moçka, Kryetar, qarku Vlorë trajtoi problemin për financimin e funksionit të mbledhjeve

dhe përpunimin, transportin e mbetjeve në Bajkaj si dhe kërkoi financimin e transportit të këtyre mbetjeve

Znj. Farrici shtoi shqetësimin e kalimit të funksioneve të decentralizuara të cilat nuk janë përlogaritur si duhet kostot e tyre dhe decentralizimi duhet të shoqërohet me standarte kombëtare minimale dhe ky buxhet i arrin të plotësojë standarde minimale për shërbimet siç është shërbimi për pyjet, arsimit parashkollor, ujitja dhe kullimi. Bashkitë kanë pengesa për huamarrje dhe duhet të lehtësohen për këto procedura. Për shkak të stokut të detyrimeve bashkitë kalojnë në vështirësi financiare.

Z. Ermal Elezi, Drejtor i Përgjithshëm, AMVV shtroi se edhe qeveria vendore duhet të sjellë politikëbërje në këshill, qoftë propozime apo çështje që të jenë iniciativë e vet.

Znj. Bufi theksoi se kemi propozuar që FSHZH të ndajë një fond për bashkitë dhe ta ndajnë vet bashkitë për të cilën nuk është marrë në konsideratë. Rritja në dhënien e shërbimeve nuk është aty ku duhet dhe nëse kërkesat e kryetarëve do të reflektohen në zërat e buxhetit dhe duhet të shikohet për një formulë ndryshe.

Z. Brahim shprehu dakordësinë me kërkesat e kryetarëve, por theksoi se 25-30% e buxhetit nuk përdoret dhe kalon për vitin tjetër.

Z. Mazniku theksoi që të gjitha zërat e buxhetit të bashkive duhet ti shkrijmë në grant. Po bëhet një analizë mbi gapin për mbulimet financiare me zvicerianët për të mbuluar shërbimet për funksionet. Granti i performancës që do pilotojmë këtë vit me projektin Btf për arritjen e objektivave automatikisht i alokohet bashkisë një sasi të parave prej 4 milion lekë.

Z. Moçka argumentoi mbi pikën 4 neni 10 ku citon se personeli i qarkut s' mund të jetë më shumë se 10 veta që nuk mund të mbulojnë funksionet tona si planet urbanistike dhe ato sociale. Kemi propozuar ngritjen e pikës zjarrëfikëse për 5 bashkitë jugore, por e pamundur.

Z. Brahim shtoi se bashkitë mund ta ngrenë në komisionin e ligjeve këtë kërkesë. Është dhe te strategjia e decentralizimit për ta riparë funksionim e qarkut.

Z. Dalipi theksoi se duhet të shihen hapësirat ligjore për plane sociale si Tirana që e përfundoi i cili do jetë publik.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ

5. Projektligjin “Për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit”

Znj. Ilva Gjuzi, Zëvendësministre, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit prezantoi projektligjin “Për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit”. Projektligji është parimi i menaxhimit të mbetjeve i përfshirë në doukmetin e politikave strategjike të menaxhimit të mbetjeve. Fjala i kaloi *Znj.*

Elvana Ramaj, Drejtor në Drejtorinë e Ekonomisë Qarkulluese, e cila theksoi se është një detyrim për prodhuesit që vendosin brenda në tregun e vendit produkte që pas përdorimit gjenerojnë mbetje që i përkasin njëres prej rrymave të mbetjeve. Prodhuesi duhet të financojë për të krijuar një sistem për të grumbulluar dhe ricikluar mbetjet duke ndjekur parimin kush ndot paguan. Fusha e veprimit të ligjit përfshin të gjithë prodhuesit që hedhin në treg produkte konsumimi si ambalazhime, automjete në fund të jetës, bateri, mbetjet e pasisjeve elektrike dhe elektronike. Akti ka detyrime financiare të parashikuara në RIA. Pushteti lokal preket të neni 27 i ligjit që të krijojë marrëdhënie me prodhuesi si dhe ul koston për bashkinë.

Përgjegjësitë e prodhuesit:

- Duhet të rregjistrohet subjekt i PZP pranë AKM;
- Raporton për produktete e vendosuar në treg;
- Mund të rregjistrohet në një SHPZP;
- Merr masa për mbetjet që gjenerohen të riciklohen;
- Prodhuesi merr masa të mbulojë 100% të kostove për ngritjen e skemës së PZP.

Znj. Farrici dakordësoi me aktin.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ

6. Projektudhëzimi “Për radhën e vendosjes së elementëve të adresës, algoritmin dhe strukturën e kodit unik të adresës dhe përdorimin e tij”

Znj. Angjela Begaj, Përgjegjës, Sektori i Gjendijës Civile prezantoi projektudhëzimin “Për radhën e vendosjes së elementëve të adresës, algoritmin dhe strukturën e kodit unik të adresës dhe përdorimin e tij. Projektudhëzimi synon përmirësimin e sistemit të adresave dhe optimizimin e shërbimeve publike ku informacioni i adresave standartizohet nëpërmjet kodit të adresës që përmban një informacion korrekt të vendbanimit të shtetasve dhe përmban 8 elemente, do të jete në nivel ndërtese, kjo e përcaktuar nga Komiteti i Inovacionit ku është pjesë dhe AMVV në këtë grup pune me urdhër të Kryeministrit nr. 208 datë 27.12.2022. Modeli i kodit unik është me 18 element ku 2 janë të bashkisë, ndërsa karakteri i tretë dhe i katërt përcaktojnë kodin postar. Karakteret 5,6,7,8 i korrespondojnë rastesisht ndërtesës, karakteret 9,10,11,12,13 i korrespondojnë numrit ekzistues të hyrjes së ndërtesës, ndërsa karakteret 14 tregojnë pozicionin e apartamentit, karakteret 15,16,17,18 i korrespondojnë numrit ekzistues të pallatit. Të gjithë elementet e parë memorizohen lehtësisht nga shtetasit me vendbanim në Republikën e Shqipërisë, ndërsa për shtetas shqiptarë me vendbanim në shtetin e huaj, adresa plotësohet sipas elementëve të shtetit të huaj.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ

7. Projektvendimi “Për disa ndryshime në Vendimin nr.1139, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026 dhe të planit të veprimit 2021-2023”

Znj Margarita Vogli, Sektori i Politikave për Rendin dhe Sigurinë Publike, Ministria e Brendshme prezantoi projektvendimin “Për disa ndryshime në Vendimin nr.1139, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026 dhe të planit të veprimit 2021-2023”. Ky plan veprimi shërben si një instrument për të bashkënduar të gjithë aktorët e interesuar shtetërorë dhe jo shtetërorë, si dhe partnerët ndërkombëtarë që ndihmojnë e mbështesin vendin tonë në kuadër të sigurisë publike në komunitet si dhe synon reflektimin e përgjegjësive të strukturave, në nivel qendror dhe atij vendor që kanë përgjegjësi në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Akti synon konsolidimin e Këshillave Vendor të Sigurisë Publike, fuqizimi i rolit të vetëqeverisjes vendore në sigurinë publike si dhe përfshirja aktive e komunitetit në çështjet e sigurisë publike. Objektivi specifik i Planit të Veprimit është dhe rritja e mbështetjes së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për Sigurinë Publike. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara, si dhe me buxhetim nga donatorë për zbatimin e Planit të Veprimit 2024-2026 të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026. Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e Planit të Veprimit 2024 – 2026”, është rreth 14 miliardë Lekë, ose rreth 140 milionë Euro. Për periudhën 2024-2026, buxheti i shtetit pritet të financojë 14 miliardë lekë ose 98% të kostove indikative totale të planit, ndërsa financimi i huaj është 209 milionë lekë ose 2% e kostove indikative. Hendeku financiar për këtë plan veprimi është në vlerën 15 milionë lekë

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t’i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ

8. Projekti “Forcimi i Kapaciteteve Institucionale Vendore për Migracionin në Shqipëri”

Endri Xhaferaj, Kordinator, Projekti “IOM” prezantoi dokumnetin mbi “Forcimin e Kapaciteteve Institucionale Vendore për Migracionin në Shqipëri”. Projekti është i financuar nga Mbretëria e Bashkuar në partneritet me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe AMVV, u përmesën fakte për evente të diasporës. Ky projekt ka qëllim përgatitjen e dokumentave për veprimet dhe dhënien e shërbimeve për të huajt, emigrantët duke krijuar standarde të performancës nëpër bashki.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t’i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ

9. Mbyllja e mbledhjes

Z. Aldrin Dalipi mbylli mbledhjen duke falenderuar zëvendësministrat, kryetarët e bashkive si dhe pjesëmarrësit nga bashkitë dhe shprehu gadishmërinë për të mirëpritur komentet/sugjerimet për projektvendimet e konsultuara.

Shtojca 1: Të pranishëm në mbledhje

Anëtarët e Këshillit Konsultativ			
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni	Institucioni/Organizata
1	Arbjan Mazniku	Ministër Shteti për Pushtetin Vendor	Kryeministria
2	Aldrin Dalipi	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Tiranë
3	Ilva Gjuzi	Zv/ministër	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
4	Klajd Karameta	Zv/ministër	Ministria e Drejtërsisë
5	Enkelejd Musabelliu	Zv/ministër	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
6	Ervis Moçka	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Vlorë
7	Agron Ivanaj	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Lezhë
8	Alma Selami	Kryeta	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Dibër
9	Arian Jaupllari	Zv/ministër	Ministra e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
10	Fran Brahim	Drejtor	Ministria e Financave
11	Gledjan Llatja	Kryetar	SHAV Kryetar i bashkisë Elbasan

Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ

E-mail: keshilli.konsultativ@amvv.gov.al Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark, ish- Shtëpia e Oficerave, Kati i VII”, Tiranë, Shqipëri

Materialet e mbledhjes që u diskutuan i gjeni në linkun e mëposhtëm;

<https://qeverisjavendore.gov.al/keshlli-konsultativ/mbledhjet-e-keshillit-konsultativ/viti-2024/8-mentor-2024/>